



Viti 2013 mund te jete viti me i erret ne historine e Tiranes. Bardheblute jane duke kaluar nje moment te veshtire dhe ne tabelen e klasifikimit gjenden te fundit dhe pa asnje shprese shpetimi. 11 pike dhe nje ndeshje e mbetur per kete vit nuk japin asnje mundesi qe Tirana te largohet nga vendi i fundit ku qendron prej nje muaji. Drejtuesit kane menduar te marrin disa lojtare ne muajin janar si perforcime por situata nuk duket aspak shpresedhenese per tifozet bardheblu qe javet e fundit kane filluar te bejne trazira ne stadiume ne shenje proteste per situaten e krijuar tek Tirana e tyre. Ndeshjen e fundit te kampionatit per kete vit, Tirana do ta luaj te shtunen perballe Teutes.